

3. Drejt marrëdhënieve binjakëzuese me qytetin Jena të Gjermanisë



Arritja e marrëveshjes së binjakëzimit me Maceratën e Italisë krijoi besimin dhe intensifikoi përpjekjet e bashkisë për të arritur të njëjtin rezultat edhe me qytete të tjera partnere, si Jena e Gjermanisë dhe La Plata e Argjentinës, madje duke u dërguar atyre edhe kopjen e marrëveshjes dhe fotot ilustruese nga ceremonia e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nga dy kryetarët e bashkive. Por, duhet thënë se ndonëse në aspektet e frymës së përmbajtjes së marrëveshjeve të binjakëzimit këto janë të unifikuara në nivel ndërkombëtar nga organizmat përkatës, në aspekt të procedurave ligjore dhe zbatimit të tyre, ka specifika që ndryshojnë nga një vend në tjetrin dhe varen shumë nga kriteret që vendosin organet vendimmarrëse në nivel lokal e qendror. Nga ana tjetër, qytete si Jena kanë krijuar marrëdhënie binjakëzuese edhe me mjaft qytete të tjera të Evropës dhe eksperiencat e tyre të mëparshme me këto qytete e bëjnë atë të përcaktojë instrumentet e duhura në vazhdimësinë e lidhjes së marrëdhënieve binjakëzuese me qytetet e reja. Pra, ajo çka rezulton në procesin e ndërtimit të marrëdhënieve binjakëzuese të Jenës me Kamzën, në dallim nga procesi i Maceratës, është se Jena e ka fokusin primar në drejtim të arritjes së bashkëpunimit me projekte konkrete dhe më pas finalizimin e marrëveshjes binjakëzuese, në një periudhë më të gjatë kohore. Kjo u konfirmua edhe në axhendën e ftesës së bërë nga Jena për pjesëmarrje të një delegacioni zyrtar nga Bashkia Kamëz, në fillim të tetorit, e cila shënoi edhe një moment kyç në marrëdhëniet bashkëpunuese drejt binjakëzimit.

Jo vetëm se ky delegacion u ftua në një nga përvjetorët më të rëndësishëm të festimeve gjermane, siç është rënia e Murit të Berlinit dhe ribashkimi i Gjermanisë, por për mënyrën e organizimit të një axhende që, si nga përmbajtja, ashtu edhe pjesëmarrja, synoi pikërisht të ndërtojë një spektër të gjerë takimesh, që në thelb përbëjnë edhe fushat kryesore drejt marrëdhënieve binjakëzuese midis Kamzës dhe Jenës. Pikërisht, takimet e delegacionit të Kamzës në Jena, në të tre mjediset e shkollave profesionale, Qendrën Kombëtare Shëndetësore, ÜAG (Uzinë, Automekanikë, Gastronomi), IGS (Shkolla për Formim Social e Integrim), jo vetëm shërbyen për të konfirmuar arritjet e këtij bashkëpunimi të suksesshëm, por edhe për të thelluar më tej në zbatim të marrëveshjes, në drejtim të ndihmave, asistencës trajnuese dhe konceptimit të qendrës së re profesionale që do të ngrihet në Kamëz, si shumë funksionale dhe në përfshirjen e të gjithë grup moshave të afta për punë. Një sfidë tjetër për t'u arritur nga Bashkia Kamëz është fusha e mjedisit, veçanërisht ajo e pastrim-gjelbërimit. Edhe këtu Jena afroi modelin e saj, që jo vetëm ka dhënë rezultate të larta për këtë qytet (një qytet tërësisht i pastër dhe i gjelbëruar në çdo pjesë të tij), por është kthyer edhe në një burim të ardhurash të rëndësishme për qytetin (në shifra 20 milionë euro në vit). Kjo, falë një sistemi organizimi që ka në formatin e vet një harmonizim perfekt të parametrave ekonomikë financiarë të një sektori privat, me varësinë e menaxhimit nga bashkia e qytetit. Por, në bazë të këtij funksionimi është përcaktimi i një skeme me efektivitet të lartë pastrimi, që fokusin e vet e ka jo thjesht në grumbullimin dhe depozitimin e mbetjeve urbane, por veçanërisht në reduktimin e tyre, në bazë të ndarjes me kosha të veçantë (organikë, letër, metalikë/plastikë, qelq) në lagjet e qytetit dhe riciklimin e ripërdorimin e tyre nga kompanitë e specializuara, që sjell impakt jo vetëm në reduktimin e mbeturinave, por edhe mbulimin e kostove dhe fitimin. Si rrjedhojë, Jena, nga një qytet problematik në këtë fushë në fillim të viteve '90, tashmë është kthyer në një qytet model për pastrim-gjelbërimin. Për analogji, duke parë situatën aktuale të Kamzës në këtë shërbim jetik për komunitetin, kjo skemë dhe ky menaxhim do të jetë tepër i përshtatshëm për Kamzën. Këto ishin edhe konkluzionet e diskutimit dhe interesimit që u arritën në takimin e zhvilluar në Qendrën Komunale të Jenës. Fusha e sportit është një tjetër prioritet në zhvillimin aktual e të ardhshëm të Kamzës, duke pasur parasysh se ky qytet ka një popullsi me moshë më të re në shkallë vendi, por edhe sepse atij i duhet të krijojë një infrastrukturë të nevojshme për të gjitha llojet e sportit. Është e njohur tashmë se edhe në këtë fushë, vitet e fundit ajo ka bërë një progres të ndjeshëm, në veçanti në sportin e futbollit (ekipi Kamza, një nga ekipet më të mira të Ligës së Parë, dhe kandidat për të kaluar në Superligë), me stadium të ri bashkëkohor dhe fushën e futbollit UEFA, por edhe në sporte të tjera, si mundja, e tashmë edhe basketbolli për meshkuj, i cili u përfshi në Superligë me rezultate mjaft konkurruese. Në planet e Bashkisë Kamëz është edhe projekti për ndërtimin e një pallati të mbyllur sporti modern, për sportet e lojërave me dorë dhe ato të ujit. Pikërisht për t'u dhënë një shtytje e mbështetje sa më të gjithanshme këtyre planeve, u përqendrua edhe diskutimi në takimin në klubin e njohur Carl Zeiss Jena, i cila ka një eksperiencë të gjerë e mjaft cilësore në të gjitha sportet: atletikë, basketboll, volejball, futboll, not etj. Baza e këtij zhvillimi janë ekipet e moshave të reja, për të cilat Jena ka programe të posaçme trajnimi, të cilat mund të jenë udhëheqëse në bashkëpunimet midis këtyre ekipeve të të

dyja qyteteve. Për këtë qëllim hartimi i një programi konkret nga ana e Bashkisë Kamëz do të jetë hapi i parë kryesor, që do të mbështetet nga Jena, nëpërmjet një modeli organizimi dhe financimi që u përshtatet nevojave të Kamzës. Jena është modeli i integritit për Kamzën edhe për faktin se ajo tashmë ka krijuar një rrjet binjakëzimesh me qytete si Porto (Portugali), Lugo (Rumani), Erlangen (Gjermani), San Markos (Nikaragua), Aubervilliers (Francë), Berkeley (SHBA) dhe një sërë partneritetesh të tjera kombëtare e ndërkombëtare. Ky lloj rrjeti përbën një shans dhe mbështetje të rëndësishme për Kamzën, po të mbahet parasysh se bashkëpunimet në rrjet janë kusht i rëndësishëm, që lehtëson ndërmarrjen e hapave integruar, nëpërmjet projekteve me karakter ndërkombëtar në nivel evropian e botëror. Kjo ishte edhe ideja kryesore që përshkoi takimet në Jena, mbledhjen solemne e takimet e delegacioneve respektive, konferencën e shtypit midis dy kryetarëve të Bashkive Jena dhe Kamza, pra se zhvillimi dhe thellimi i këtyre bashkëpunimeve me vende si Shqipëria, që aktualisht është jashtë BE-së, por aspiron në të ardhmen e shpejtë të bëhet pjesë e saj, është një proces vendimtar për të, jo vetëm si përfitim zhvillimi, por edhe integrimi.